

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	205-23-8493-2-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për **Hartimi i projekteve dhe konsullenca teknike (Shërbimet Gjeodezike)**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Consult Engineering sh.p.k

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Shqipër Kuka, pn.

(Adresa)

Kaçanik

(Vendi)

71000

(Kodi postar)

044431224

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Jakup Kuka


(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@consult-eng.com

(Adresa elektronike)

29/08/2023

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshtetimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

***Njoftimi për kontratë me datë 10.08.2023***

***Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 01.09.2023***

***Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi ekonomikisht më i favorshëm***

***Kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar me datë 25.08.2023***

***Njoftimi për refuzim të kërkesës me datë 28.08.2023***

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

Data e fundit për dorëzim të tenderëve është 01.09.2023

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, me datë 25.08.2023 kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, ku kemi pasqyruar në mënyrë të qartë të gjitha argumentet tona se AK ka vendosur kriteret për vlerësim në kundërshtim me LPP, si dhe dokumentacionin sekondar legjislativ.

Me datë 28.08.2023 AK ka publikuar një “Njoftim” përmes të cilit ka refuzuar Kërkesën tone për rishqyrtim, duke e vlerësuar si të jashtë afatshme. Ne fakt, konsiderojmë se AK vepron krejtësisht në kundërshtim me LPP, neni 108/A, paragrafi 3.1 sepse si është e mundur të vlerësohet kërkesa jonë jashtë afatit kur data e fundit për dorëzim të tenderëve është 01.09.2023, ndërsa ne kemi dorëzuar kërkesën me datë 25.08.2023...?!!

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Shkeljet e pretenduara sipas LPP

- ✓ Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), neni 7, neni 52.3, neni 108/A, paragrafi 3.1, 8 dhe 10;
- ✓ Rregullore Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik, neni 19.3;
- ✓ Rregullore Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik, neni 27.10;
- ✓ Rregullore Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik, neni 45.27;

✓ UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK. neni 9.11

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Me datë 10.08.2023 Ministria Infrastrukturës ka publikuar njoftimin për kontratë për tenderin me titull “Hartimi i projekteve dhe konsullenca teknike (Shërbimet Gjeodezike)”. Me datë 22.08.2023 kemi dorëzuar kërkesën për sqarime të dosjes së tenderit, ku me datë 23.08.2023 AK ka publikuar përgjigjet ndaj kërkesës tone. Duke qenë se ne përgjigjet e ofruara AK ka hedhur poshtë pothuajse çdo kërkesë që kemi shtruar, atëherë me datë 25.08.2023 kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me pretendimet specifike ankimore për shkeljet ligjore të AK në lidhje me kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë, si dhe kriteret e vlerësimit. Me datë 28.08.2023 AK ka publikuar një “Njoftim” përmes të cilit ka refuzuar Kërkesën tone për rishqyrtim. AK ne vend se të përmirësojë gabimet e bëra me shkeljet përkatëse ligjore, bën pikërisht të kundërtën, vazhdon të rris numrin e shkeljeve ligjore të LPP. Andaj, në vijim po paraqesim detajisht pretendimet tona ankimore të mbështetura në fakte dhe argumente specifike.

**Pretendim ankimor 1.**

AK ka shkelur LPP, nenin 108/A, paragrafi 3.1 për shkak se ne kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore që parasheh neni në fjalë, citojmë:

3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:
  - 3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Data finale për dorëzim të tenderëve është 01.09.2023, ndërsa ne kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datë 25.08.2023. Nëse dita e fundit për dorëzim është dita 0, i bie që dita e 5 është dite e Diele, datë 27.08.2023. Qarte shihet se kemi dorëzuar para se të përfundojë afati prej 5 dite para ditës finale për dorëzim të tenderëve. **Mirëpo, AK ne kundërshtim me LPP, neni 108/A, par. 3.1 në njoftimin e tij e cilëson kërkesën tonë si të jashtë afatshme.**

Gjithashtu, AK ka shkelur LPP, neni 108/A, paragrafi 8, citojmë:

8. Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:
  - 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni;
  - 8.2 ankesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në paragrafin 1 të këtij neni;
  - 8.3 ankesa nuk përputhet me kërkesat e përmendura në paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni;
  - 8.4 autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.

### **Pretendim ankimor 2.**

Ndaj kërkesës tonë për rishqyrtim AK me date 28.08.2023 ka publikuar “Njoftim”, çfarë është ne kundërshtim me LPP, neni 108/A, paragrafi 10, sepse refuzimi i kërkesës për rishqyrtim ose aprovimi i saj mund të bëhet nga **AK vetëm me anë të një vendimi dhe jo njoftim**, citojmë neni 108/A, par. 10:

**10. Autoriteti kontraktues mund, me anë të një vendimi:**

**10.1 të refuzojë kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabaza;**

**10.2 të miratojë një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar;**

### **Pretendim ankimor 3.**

AK ka paraqitur në dosjen e tenderit, në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, si ne vijim “1. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje të tenderit tek Aneksi 1.” Tek Aneksi 1, në listën përkatëse AK ka paraqitur kërkesa të cilat fare nuk kanë të bëjnë me lëndën e kontratës si p.sh.:

- *Plateia (ose softwer të ngajshëm për projektim të rrugëve) software me liçencë në pronësi, pronësia të dëshmohet me faktur të rregullt tatimore.*

**Duke vendosur kërkesa të cilat nuk kanë të bëjnë me lëndën e kontratës, AK tenton të favorizoj një OE dhe të diskriminojë OE të tjerë, gjithashtu të reduktoj dhe eliminoj konkurrencën në mes të OE. Me këtë rast AK ka shkelur nenin 7, paragrafi 2, si dhe nenin 19.3 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurim publik. Andaj, kërkesa e tillë duhet të largohet nga kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.**

### **Pretendim ankimor 4.**

AK ka paraqitur në dosjen e tenderit, në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, si ne vijim “1. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje të tenderit tek Aneksi 1.” Tek Aneksi 1, në listën përkatëse AK ka paraqitur kërkesa të cilat fare nuk kanë të bëjnë me lëndën e kontratës si p.sh.:

- *Dron në pronësi i dedikuar për inspektim, monitorim apo relivim gjeodezik, i paisur me kamera dixhitale me rezolucion jo më pak se 36 megapixel. Të ketë një inxhinier të trajnuar dhe certifikuar për përdorimin e dronit, përdorimin e të dhënave gjeohapësinore, kjo të dëshmohet me certifikatë origjinale ose kopje të noterizuar.*

**Specifikimi për rezolucionin e kamerës në jo më pak se 36 megapixel është gjithashtu vetëm kriter favorizues për një OE dhe diskriminues për OE të tjerë, dhe si i tillë është në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 2, si dhe nenin 19.3 të Rregullores nr. 001/2022 për**

**prokurim publik.** Referuar Aneksit 1 te dosjes se tenderit, ku përshkruhen specifikimet teknike ne lidhje me kontratën, aty nuk kërkohet fare qe matjet gjeodezike për aktivitetet përkatëse duhet te zhvillohen me Dron. Gjithashtu referuar bazës primare dhe sekondare legislative ne Kosove nga fusha e gjeodezisë dhe kadastrit, Droni nuk është pajisje e domosdoshme për te realizuar matjet gjeodezike, ndërsa nuk është fare pajisje e lejuar për matje për qëllime te shpronësimit dhe kadastrit. Andaj, kërkesa e tillë është kundërligjore sepse fare nuk ka te beje me kërkesat e lendes se kontratës. Si e tille duhet te largohet krejtësisht nga kërkesat minimale për pajisje te nevojshme, ose se paku te largohet kushti për rezolucionin e kamerës se dronit.

#### **Pretendim ankimor 5.**

Në vijim te Aneksit 1, AK gjithashtu ka paraqitur kërkesa te cilat favorizojnë vetëm nje OE potencial dhe diskriminojnë OE te tjerë, si p.sh.:

- *Lidhur me gjendjen ekonomike e financiare, konsulenti/ofertuesi duhet të Plotësoje kërkesat:*

*Të ketë Projekt të Hartuar të Elaboratit për Shpronësim të rrugëve (Autoudhëve, rrugëve Nacionale, Rrugëve Rajonale) në 3 vitet e fundit.*

Me këtë rast AK e ka kufizuar eksperiencën e OE ne vetëm projekt te elaboratit te shpronësimit duke favorizuar vetëm një OE potencial dhe diskriminuar OE te tjerë, gjithashtu duke reduktuar dhe eliminuar konkurrencën ne mes te OE. Me këtë rast AK ka shkelur nenin 7, paragrafi 2, si dhe nenin 19.3 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurim publik.

Kërkesa ne lidhje me eksperiencën e OE e cila është ne përputhje me LPP, do te duhej te ishte: “OE duhet të ketë eksperiencë në punë të ngjashme”. Kërkesa e tillë është në përputhje me LPP sepse i përgjigjet plotësisht titullit të tenderit si dhe shërbimeve të cilat kërkohen, si dhe mundëson konkurrencën e lirë në mes të OE potencial. Për argumentim të mëtutjeshëm, duke ju referuar paramasës për shërbime gjeodezike në dosje të tenderit, shihet qartë se hartimi i elaboratit të shpronësimit është vetëm njëri prej nëntë shërbimeve që kërkohet me këtë tender dhe jo shërbimi i vetëm.

#### **Pretendim ankimor 6.**

Në kuadër të Aneksit 6 të dosjes së tenderit, Kriteret për dhënien e kontratës janë paraqitur si në vijim:



**Kriteri për dhënien e kontratës**

☒ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

Nënkriteret		Koeficient
1	Përvoja në punët e ngjashme e konsulentit	0.20
2	Metodologjia e Propozuar punimeve (metodologjia e punimeve, aftësia organizative)	0.10
3	Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar	0.40
4	Çmimi me i Ulet i Ofruar	0.30

**6.1)** Kriteret e vlerësimit në kuadër të propozimit teknik, siç është Përvoja në punët e ngjashme e konsulentit – 0.2, si dhe Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar – 0.4, që gjithsej përbëjnë 60% të vlerësimit teknik janë gjithashtu të definuara edhe si kritere të përzgjedhjes në kuadër të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional. Ju lutemi referohuni dosjes së tenderit faqe 24, 25 dhe 26 ku AK i përfshinë kriteret e përzgjedhjes edhe në kritere për dhënien e kontratës.

Andaj si të tilla, kriteret e vlerësimit janë në kundërshtim me LPP, neni 52.3, citojmë:

*Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kriteret e tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencë teknike.*

**6.2)** Gjithashtu, kriteret e tilla të vlerësimit janë në kundërshtim edhe me dokumentet tjera nënligjore siç është Rregullorja nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik, si dhe UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, për shkak se:

**Referuar Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik, neni 27.3 i saj thotë, citojmë:**

*“27.3 Nëse kriteri është ‘tenderi ekonomikisht më i favorshëm’, kontrata duhet ti jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante. Përveç çmimit AK mund të përfshijë kritere tjera relevante për lëndën e kontratës, siç janë:*

- a. Karakteristikat e cilësisë*
- b. Kostot Operative, të mirëmbajtjes dhe kosto tjera të jetë-gjatësisë*
- c. Karakteristika funksionale, teknike, mjedisore, estetike ose të ngjashme*
- d. Shërbimi i pas-shitjes dhe asistencës teknike”*

Nga neni më sipër është e qartë se kriteret e dhënies së kontratës duhet ti referohen vetëm lëndës së kontratës (karakteristikat e cilësisë, kostot operative të mirëmbajtjes dhe kosto tjera, karakteristikat funksionale, teknik mjedisore, estetike, shërbimi i pas-shitjes dhe asistencës teknike) dhe jo kapacitetit të ofruesit, siç ka vepruar në këtë rast AK duke

vendosur eksperiencia e kompanisë në projekte të natyrës së njëjtë, si dhe eksperiencia e stafit teknik si kritere për dhënien e kontratës.

**6.3) Neni 45.27 i po të njëjtës rregullore gjithashtu sqaron se, citojmë:**

*“45.27 Neni 52.4 i LPP-së kërkon që të bëhet një dallim i qartë në mes të kritereve të dhënies dhe kritereve të përzgjedhjes. Kriteret e dhënies kanë të bëjnë me tenderin, ndërsa kriteret e përzgjedhjes kanë të bëjnë me kualifikimet dhe kapacitetet e tenderuesit. Autoritetet kontraktuese duhet të jenë të vetëdijshëm se për shembull, kriteri i dhënies si karakteristikat mjedisore duhet të lidhet në mënyrë strikte me karakteristikat e lëndës së kontratës (pajisja duhet të përbëhet nga një shkallë e lartë e materialeve të riciklueshme, fotokopjuesi duhet të ketë konsum të ulët të energjisë). Çdo karakteristikë e tillë nga ana e ofertuesit (emisioneve të ulëta nga vendet e prodhimit, administrimin mjedisor të proceseve të prodhimit), nuk duhet të përfshihen si kritere të dhënies”.*

**6.4) Kriteret minimale për kualifikim siç është eksperiencia e kompanisë dhe eksperiencia e stafit, siç janë vendosur edhe si kritere për dhënie të kontratës, gjithashtu janë në kundërshtim edhe me nenin 27.10 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik, citojmë:**

*“27.10 Kriteret minimale për kualifikim (kriteret e përzgjedhjes) nuk përdorën si kritere në procesin e dhënies së kontratës. Tenderuesit do të konsiderohen të kenë përmbushur kërkesat minimale në lidhje me kapacitetin e tyre për të përformuar kontratën që do të thotë që kriteret në lidhje me përvojat paraprake dhe historikut të kompanisë nuk do të shihen si kritere në procesin e dhënies së kontratës”.*

**6.5). Gjithashtu, UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, neni 9.11 sqaron si në vijim, citojmë:**

*“9.11 Gjatë përcaktimit të kritereve dhe rëndësisë së tyre relative, mund të merren parasysh:*

- *Kriteret duhet të përcaktohen rast pas rasti.*
- *Rëndësia relative duhet të pasqyrojë rëndësinë relative për autoritetin kontraktues.*
- *Kriteret duhet të lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe jo me aftësinë e operatorëve ekonomikë për të përmbushur kontratën.*
- *Kriteret duhet të përshtaten me specifikimet.*
- *Kriteret duhet të formulohen në mënyrë të qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshme për operatorët ekonomik.*
- *Vetëm kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë mund të aplikohen.*
- *Kriteret duhet të përcaktohen në përputhje me LPP-në dhe parimet themelore të prokurimit”.*



**Për më tepër, pikërisht për këto shkelje ligjore ekziston vendim i OSHP i datës 30.05.2023, nr. 168/23, i cili qartë i ka aprovuar pretendimet tona ankimore, duke i cilësuar kriteret e tilla (përvoja e punës e ngjashme e konsulentit, kualifikimet e stafit) të vendosura si kriteret për dhënie të kontratës janë në kundërshtim me LPP (nenet e sipër cekura) dhe Rregulloren.**

Bazuar në deklaratimet si më lartë, argumentet që i kemi ofruar, si dhe duke qenë se AK ka refuzuar kërkesën tonë për të rishqyrtuar kërkesat minimale dhe kriteret e vlerësimit, kërkojmë nga OSHP, si dhe në mbështetje të plotë në LPP-në dhe legjislacionin sekondar, të nxjerrë këtë:

#### **VENDIM**

- I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE “Consult Engineering” SH.P.K.
- II. **ANULOHET** njoftimi i AK – Ministria e Infrastrukturës, i datës 28.08.2023, mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe njoftimi për kontratë i datës 10.08.2023.

#### **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Konsiderojmë se si rezultat i shkeljeve ligjore si më sipër, ne mund të na shkaktohen dëme të larta financiare, diku rreth 98,200 €.**

#### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Në bashkëngjitje të Ankesës janë dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- c) *një kopje e njoftimit për vendimin e AK.*
- d) *një kopje e kërkesës për rishqyrtim e datës 25.08.2023*
- e) *një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se, e datës 28.08.2023*
- f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*